



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA GRAMSH
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4761 / prot.
13

Gramsh, më 07 / 01 / 2022

VENDIM

Nr.133, datë 29.12.2021

PËR
MIRATIMIN E LISTËS EMËRORE TË NXËNËSVE TË ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR QË FREKUENTOJNË NË SHKOLLA PROFESIONALE TË
ARSIMIT TË MESËM PUBLIK TË CILËT PLOTËSOJNË KRITERET LIGJORE
PËR PËRFITIMIN E BURSËS PËR VITIN MËSIMOR 2021-2022

Këshilli Bashkiak i mbledhur në datë 29/12/2020 mbështetur në Ligjin nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, neni 21 pika 1 dhe 3, neni 22 si dhe VKM. nr.666 datë 10.10.2019 për “Kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet e arsimit publik , për vitin shkollor 2021-2022, pika 2.4 /b (jashtë kriterit ekonomik) për nxënësit me vendbanim të përhershëm në zonat verilindore dhe juglindore të vendit ku përfshihet Bashkia Gramsh, si dhe shkresës nr.19590 prot, datë 12.11.2021 nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, për planin e shpërndarjes së bursave për nxënësit që ndjekin vitin e parë në shkollat e mesme të arsimit profesional me banim në juridiksonin e Bashkisë Gramsh, numri i bursave të miratuara është 28 (njëzet e tetë), si dhe në dokumentacionin e paraqitur nga zv/Kryetari i Bashkisë.

V E N D O S I

1. Të miratojë listën emërore me **22 (njëzet e dy) nxënës** me 100 % B (Bursë të plotë) që ndjekin studimet në shkollat e mesme profesionale, të regjistruar në vitin e parë shkollor dhe që plotësojnë kriteret ligjore për përfitimin e bursës për vitin shkollor 2021-2022.
(Lista emerore me të dhënat përkatëse, bashkëngjitur këtij projekt-vendimi si pjesë përbërëse e tij).
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Xhulia GJINI

Konceptoi: Xh.Gjini
Pranoi: G.Lena
Miratoi: G.Lena
Dosja nr:
Afati i ruajtjes: RHK

Kryetari i Këshillit Bashkiak

Greta LENA